



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.27.03.2026, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi, Albanë Shillova Shalaku, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena, Abdylrahman Krasniqi dhe Dorentina Krasniqi

Të pranishëm të tjerë: Drejtorët komunal,

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkeses së Kryetarit të Komunës me nr. 02-020-01-7220-26 për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)
4. Shqyrtimi i kërkeses së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkeses së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për themelimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave të fshatrave
6. Shqyrtimi i kërkeses së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për miratimin e Draft-Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës për zgjedhjen e delegatëve që do të perfëqesojnë Komunën e Obiliqit
8. Shqyrtimi i kërkesës së Bajram Krasniqit, me nr. 01-070/05-0004974/26, dt. 19.02.2026 për rregullimin/zhvendosjen e rrugës në Plemetin
9. Shqyrtimi i Kërkesës me nr. 01-070/05-0006422/26 – Zymer Morina për emërimin e shkollës fillore dhe çerdhes në Milloshevë
10. Shqyrtimi i kërkesës së anëtarit të Kuvendit z.Mirena për orarin e kujdestarisë së barnatoreve në Obiliq
11. Të ndryshme

Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr. 02-020-01-7220-26 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr. 02-020-01-7220-26 për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për i'a rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Obiliqit.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për themelimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave të fshatrave.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për i'a rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për themelimin e Komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave lidhur me procesin e zgjedhjes së Këshillave të fshatrave.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti rishqyrtimin e kërkesës së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për miratimin e Draft-Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për i'a rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DAP me nr. 03-104-02-7222-26 për miratimin e Draft-Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës për zgjedhjen e delegatëve që do të përfaqësojnë Komunën e Obiliqit.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Unë e kam një pyetje. E kemi bërë edhe më heret në legjislaturën e fundit dhe a duhet gjithsesi të sjellet në Kuvend si pikë e rendit të ditës dhe të votohet, pasi që ne vetëm i kemi dërguar propozimet që ka qenë kryesuesi, shefat e grupeve të dy partive, që ka qenë z.Enver, ju më duket keni qenë me znj.Ajshe dhe një prej komuniteteve.

Kryesuesi – Jo, neve na ka bërë kërkesë Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe u interesova sepse nuk më kujtohej se në Kuvend e kemi bërë përzgjedhjen herën e kaluar. Këtë çështje duhet ta bëjë Kuvendi dhe nuk janë krejtë shefat por vetëm 2 anëtarë duhet të shkojnë prej Kuvendit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Asociacionit të Komunave të Kosovës për zgjedhjen e delegatëve që do të përfaqësojnë Komunën e Obiliqit.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – E kemi shqyrtimin e kërkesës nga Bajram Krasniqi, i cili kërkon një pronë, një rrugë që është në Plemetin, me ndryshu pozicionin dhe me i dhënë më shumë Komunës se që po merr. Rruga për të cilën po bëhet fjalë nuk është pronë komunale, por është pronë shoqërore në pronësi të Agjencionit Kadastral të Kosovës, kështu që ne nuk mundemi me shqyrtu. Megjithatë, ne mund t'i rekomandojmë DPUKP- së, që ta informoj palën dhe ti ndihmojë në çdo hap që ka nevojë.

Vlora Mjekiqi Kabashi – E njejta palë ka qenë në vitin 2025, nëse nuk gaboj, në gusht, shtator apo tetor dhe Ministria na e ka kthyer sepse nuk kemi pasë të drejtë të merremi me këtë çështje.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DPUKP-së, kërkesën nga Bajram Krasniqi për rregullimin/zhvendosjen e rrugës në Plemetin.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga Zymer Morina për emërimin e shkollës fillore dhe çerdhes në Milloshevë. Kjo kërkesë na ka ardhë për herë të dytë, edhe pse palës i është kthyer një përgjigje. Unë drejtoreshës i kam rekomandue që të merret me këtë çështje dhe palës t'i kthehet përgjigje.

Abdyrrahman Krasniqi – Mendoj se ne duhet t'i referohemi përgjigjet e kaluara, sepse ishin shumë kritere. Unë jam marrë gjatë javës së kaluar me çështjen për me përcaktue përshembull, emërtimin e një shkolle duhet me qenë një figurë gjithë kombëtare, do të thotë respekt për ata që kanë dhënë shumë për liri. Besoj se Drejtorja e Arsimit duhet me i'u referuar përgjigjen, sepse ne mundemi çdo muaj me pasë këso kërkesash dhe ne si Kuvend nuk mund të japim përgjigje e me bërë ndryshime tash pa marrë parasysh çfarë na konvenon neve.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota, për ia rekomanduan DKA-së kërkesën nga Zymer Morina për emërimin e shkollës fillore dhe çerdhes në Milloshevë.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së anëtarit të Kuvendit, z.Mirena për orarin e kujdestarisë së barnatoreve në Obiliq. Ne e kemi biseduar edhe në mandatin e kaluar disa herë këtë çështje kemi bërë kërkesa dhe kemi bërë këtë konstatim se pas orës 11 dhe 12 qytetarët nuk po kanë ku me marrë barna.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Me dt.02.03.2022 kjo Rregullore e ka krye debatin publik dhe është sjellë në Kuvend me dt.28.04.2022, ku është marrë vendim për aprovimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të bizneseve në Komunën e Obiliqit. Konkretisht, neni 16 i Rregullores i specifikon veprimtaritë e barnatoreve, oedinancave dhe klinikave private, ku i obligon për me kujdestarue çdo ditë, por kujdestaritë i përcakton Drejtorja e financave me Drejtorinë e shëndetësisë. Kjo është një Rregullore që i obligon veprimtaritë të punojnë dhe të kujdestarojnë edhe gjatë vikendeve dhe festave. Mirëpo pse nuk është realizuar kjo ne që kemi qenë prezentë një pjesë e dijmë se një anëtar i Kuvendit ka kundërshtuar lidhur me këtë çështje dhe nuk është realizue asnjëherë. Pra, krejtë çka duhet të bëhet është se Drejtorja e financave me Drejtorinë e shëndetësisë, qysh sot mund ti kontaktojnë barnatoret vetëm të kërkojnë nga ata se në cilën ditë e duan orarin dhe të mos pyesin fare por ta vendosin orarin çdo muaj.

Kryesuesi – Mendoj se është mirë që si temë ta bisedojmë edhe një herë, por deri atëherë Drejtorja bashkë me Kryetarin, dhe operatorët duhet ta bëjnë një plan se çka është vendosë. Atëherë, ka qenë z.Fidan Ahmeti që ka reaguar, sepse të njejtin biznes e menaxhon, ka marrë mbështetje në njëfarë mënyre në heshtje të shumicës dhe ne nuk kemi mundur me shkuar më tutje. Ne të gjithë kemi dhënë kontribut dhe kemi kërkuar që në Rregullore të përfshihen këto elemente, sepse nuk është në rregullë, që prej Obiliqit të shkohet në një qytet tjetër për të blerë barna.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Konkretisht neni 16 i ka gjithsejt 6 pika, vetëm në lidhje me operimin e barnatoreve dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit, pavarësisht përkatësisë politike, kanë dhënë kontribut që janë marrë parasysh dhe janë përfshi në këtë Rregullore. Mendoj se i specifikon dhe sqaron shumë mirë orarin dhe gjithçka që duhet për QKMF-në dhe barnatoret private. Mirëpo, atëherë është thënë kinse janë të rrezikuar po i sulmojnë gjatë natës, ndoshta nuk ka punë dhe unë duhet ta paguaj punëtoreshën nga xhepi im-gjëra të kota. Pra, konkretisht është obligim i dy Drejtorive me formue orarin së bashku me operatorët dhe me vendosë duan apo nuk duan atëherë ndëshkohen, sepse është Drejtorja e inspeksionit; dhe është për të mirën e qytetarëve.

Albertina Dedinca – Ju njoftoj se ne sot do të takohemi bashkë me drejtorin e financave, me operatorët ekonomik në këtë rast barnatoret dhe meqenëse janë 7 barnatore, secila mundet orarin e kujdestarisë një ditë të javës me mbajtë. Ne i kemi bërë 2 modalitete që do të diskutojmë me ata dhe njëherë me mirësi po i takojmë po i pyesim se në cilën ditë mundën me mbajtë dhe në fund të ditës është obligim ligjor që rrjedhë prej atij dokumenti të marrim vendim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota, për i rekomanduan Kuvendit Komunal, shqyrtimin e kërkesës së anëtarit të Kuvendit z.Mirena, për orarin e kujdestarisë së barnatoreve në Obiliq.

Kryesuesi – Ju njoftoj se në kohën e fundit e kemi çështjen e mbeturinave, që kemi telashe të madhe sepse KRM "Pastrimi" jo vetëm në Obiliq, por në të gjitha Komunitat që i mbulon ka telashe shumë të mëdha arsytet e të cilave ne as nuk jemi kompetentë me i ditë për Komunitat tjera. Megjithatë, ne e dijmë se kemi kërkesa shumë të mëdha për të bërë diçka në këtë drejtim. Një ekipë i juristëve kanë punuar për të bërë një plotësim ndryshim në Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave dhe ajo që kisha kërkuar unë është me i përshpejtuar pak hapat që ai dokument me dalë në debat publik, pastaj të miratohet.

Abdyrrahman Krasniqi – Unë veç kam qenë drejtor i shërbimeve publike dhe kam qenë aksionar atje, pastaj kam vazhduar dhe isha edhe drejtor i ambientit. Sa i përket KRM "Pastrimi" isha në Komision dhe kemi qenë si Komunitat pjesëmarrës në plotësim ndryshim të Ligjit për mbeturina në nivel të vendit. Në të njëjtën kohë kemi qenë edhe anëtarë të Komisionit për përpilimin e Rregullores, e cila është subvencionuar nga Gizi. Unë e kam dhënë mendimin tim edhe nëpër takimet private. Mendoj se duhet pasur kujdes, sepse ka metoda, ka mënyra, në të cilat mundemi me kaluar në vetëmenaxhim, dhe mos me i'a mohuar vetes të drejtën me qenë nesër përfitues i organizatave të huaja, edhe të një fondi që është grand mbështetur nga gjermanët në vlerën prej 220 milionë euro. Ato janë paraparë për blerjen e kamionëve të ri, krijimin e deponisë regjionale që ende nuk është vendosur, kontejnerëve në stacionet e mbeturinave. Ne si Komunitat, më mirë është të kalojmë në një vetëmenaxhim ku ne e kemi edhe të hapur një konto me kërkuar me bë aktive që mos me përjashtuar veten në të ardhmen me qenë pjesë e këtyre përfitimeve. Pajtohem plotësisht se menaxhimi është në nivelin 0 është shumë keq dhe ne si Obiliq mundësinë me pasë impakt në menaxhim e kemi 0 sepse nuk na pyet askush. Për këtë arsye mendoj se është mirë me hapë një debat dhe unë jam për me pasë ndryshime me kaluar në një vetëmenaxhim, por nuk jam për me privu Komunitat e Obiliqit në të ardhmen prej përfitimeve të fondeve të caktuara. Ndoshta, është mirë që Kryetarët e Komunitatve me qenë më bashkëpunues me njëri tjetrin sepse unë nuk besoj se ne mund të bëjmë zgjidhje si Komunitat. Edhe fondet të cilat i mbështetë Bashkimi Evropian janë vetëm nëse ne kemi bashkëpunim regjional përndryshe Komunitat për Komunitat nuk paguhet investimi në bazë të shërbimit që ofrohet. Unë e mbështeti daljen në debat të Rregullores dhe kisha pasë dëshirë me qenë sa më transparentë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal dhënien në debat publik të Draft Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr.03/2024 me të cilën është plotësuar dhe ndryshuar Rregullorja nr.02/2023 për menaxhimin e mbeturinave në Komunitat e Obiliqit.

Pika 11 e rendit të ditës

Labintot Mirena – Unë e kam një kërkesë nga banorët e fshatit Palaj, për një ambullantë që është e ndërtuar aty moti dhe është jashtë funksionit me kthye në shtëpi për të pame. Fshati Palaj nuk ka një vend, apo shtëpi, të këtij lloji dhe ish kolegu im z.Shaip Paloja dhe unë kemi kërkuar që këtë ta kthejmë në shtëpi për të pame në fshatin Palaj. Unë kisha kërkuar mundësisht të jetë shtëpi për të pame sepse edhe kështu është duke u rritur vetvetiu.

Kryesuesi – Besoj se mundësisht drejtoresha e shëndetësisë do ta shqyrtoj këtë kërkesë dhe në seancën e ardhshme do të na japë një përgjigje.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Nëse, nuk gaboju gjatë vitit 2020 ose 2021 mund të shikohet nëse është marrë vendim nga Kuvendi Komunal, për kthim të ambullantës në shtëpi për të pame.

Kryesuesi - Meqë, nuk kemi diskutime tjera, atëherë edhe e mbylli seancën.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45'

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azize Zeneli

